



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/36018, 28 Maj 2024

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 18 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, merr këtë:

VENDIM

Nr.18/2024

Mbi formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

1. **MIRATOHET**- Vendimi për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës .
2. Komisioni ankesave sipas këtij vendimi përbehet prej 5(pesë) anëtarëve si me poshtë:

- 2.1. Shqiprim Muriqi anëtarë i kuvendit nga subjekti i LDK-së,
- 2.2. Bujar Agusholli anëtarë i kuvendit nga subjekti i LVV-së,
- 2.3. Albulena Mujaj Bajraktaraj - anëtarë nga ekzekutivi i komunës - drejtoreshë në DMS.
- 2.4. Nita Panduri Mullarama - anëtarë nga ekzekutivi i komunës – drejtoreshë në DA ,
- 2.5.Gent Agolli anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.

3. Kryesuesi i Komisionit të ankesave zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit .
4. Mandati i komisionit të ankesave është është dy (2) vite brenda mandati të Kuvendit të Komunës.
5. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit ankesave është:

- 5.1 Pranimini i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave,
- 5.2 Shqyrtimi i ankesave,
- 5.2 njoftimi mbi vendimin e marrë të kryesuesit dhe kryetarit të komunës.

6. Administrata e Komunës i ofronë përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesës se tyre.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
8. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në ëeb faqen e Komunës së Pejës

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
Z. Rexhep Kurtbogaj